REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

| | | | |
|---|---|---|---|
| Njësia org. Org.Jedinica Org.Unit | SP-02 | Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No. | 571-2/25 |
| Nr. i Faqeve Br. Stranica No.Pages | -01- | Data: Datum: Date: | 27.02.25 |

PRISHTINË / A

No.1

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada - Government***

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostorno Planiranje i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planningand Infrastructure*

***Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm /Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary***

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 26.02.2025 |
| REFERENC-Ë: | |
| PËR/ZA/TO: | **Nexhmedin Daci,** Drejtor i Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Hanit të Elezit |
| CC: | **Mehmet Ballazhi,** Kryetar i Komunës së Hani të Elezit |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | **Izedin Bytyqi**, U.D. Sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | **Vendim për pëlqim për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt-"Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2025-2033"** |

I nderuar Nexhmedin Daci,

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor neni 11 (paragrafi 1.9, nën-paragrafi 1.9.1) Komuna e Hanit të Elezit ka dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 03.02.2025 me numër të protokollit 571/25, kërkesën "*Kërkesë për pëlqim*" për **hapjen e shqyrtimit publik** të ***Projekt-"Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2025-2033".***
Sipas nenit (9 paragrafi 2 nën-paragrafit 2.3), Ministria Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është përgjegjëse për vlerësimin e përputhshmërisë së *Projekt "Plani Zhvillimor Komunal të Hanit të Elezit 2025-2033"* me "*Planin Hapësinor të Kosovës –Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+*" dhe *Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.08/2017 Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.*

Duke u bazuar në nenin 20 të Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor dhe në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 05/2014 për Përgjegjësit e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në Planifikim Hapësinor, Ministria nxjerr Vendim për pëlqim, që Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit sipas procedurës për Përgjegjësitë e Autoritetit Komunal për Planifikimit dhe Menaxhim Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor**, mund të bëjë hapjen e shqyrtimit publik.**

Me respekt,